

RS 2  
A.1

# BULETINI I SHKENCAVE GJEOLOGJIKE

VITI VIII (XXV) I BOTIMIT

2

1989

Tiranë

## GJELOGJI

## DISA VEÇORI PETROLOGJIKE TË OFIOLITEVE TË SHQIPËRISË

M. Shallo\*, Dh. Kote\*\*, A. Vranaj\*\*, I. Premti\*

Në këtë artikull jepet një vështrim mbi ofiolitet e Shqipërisë, disa nga veçoritë kryesore të vendosjes gjeologjike e të petrologjisë së tyre. Evidentohet prania e ofioliteve të tipave «perëndimor» e «lindor», tiparet kryesore të prerjeve të tyre, veçoritë petrokimiike e petrografike të përbërësve ofiolitikë. Ofiolitet, «perëndimorë» pranohen të formuar në kushte të hapjes së një baseni të ngushtë oceanik, ndërsa ata «lindorë» në kushte të një mjeti harku ishullor ensimativ. Theksohet nevoja e përpunimit të mëtejshëm të skemave paleogeografike të formimit të ofioliteve në përgjithësi.

### H Y R J E

Në punimet dhe në studimet gjeologjike, krahas rritjes së njohjes shkencore të gjeologjisë së Shqipërisë është thelluar edhe njohja e gjeologjisë, petrologjisë e metalogjenisë së ofioliteve, që përfaqësojnë dukurinë më thelbësore të gjeologjisë së Albanideve dhe që paradesin interes metalogjenik të veçantë. Arritjet shkencore në studimin e ofioliteve janë pasqyruar në një sërë studimesh: në tekstet monografike «Gjeologjia e Shqipërisë (1982) dhe «Tektonika e Albanideve (1985), në studimin monografik «Magmatizmi ofiolitik i R.P.S.SH. (1985), në studime të veçanta: Caslli H. etj. 1983, Çina A. (1987), Dede S. (1969), Gjata K. (1980), Kodra A. etj. (1983), Ndojaj I. (1963, 1978), Premti I. (1984), Shallo M. (1967, 1972, 1980, 1985), Tërshana A. (1985), Turku I. (1981), Vranaj A. (1983); etj. si dhe në mjaft studime mbi mineralet e dobishme të lidhura me ofiolitet e vendit tonë.

### II — VENDOSJA GJEOLOGJIKE E OFIOLITEVE TË ALBANIDEVE

Ofiolitet e Albanideve janë pjesë përbërëse e brezit ofiolitik Mesdhetar-Alpin dhe lokalizohen në sektorin ndërmjetës të ofioliteve «perëndimorë» dhe «lindorë»; ndërtojnë gati tërësisht zonën e Mirditës, zenë një sipërfaqe prej rreth  $4300 \text{ km}^2$  (fig. 1).

Në drejtimin juglindor ata vazhdojnë me ofiolitet e Pindit-Vurinosis, ndërsa në skajin verior ballafaqohen me nënzonën e Cukalit dhe

\* Institut i Studimeve dhe Projekteve të Gjeologjisë në Tiranë.

\*\* Fakulteti i Gjeologji-Miniera në UT «ENVER HOXHA».

stratigrafik dhe historia gjeotektonike pasofiolitike e njëjtë e tyre, është në mospërputhje me dallimet petrologjike të dy brezave ofiolitikë.

### LITERATURA

- Caslli H., Çina A., etj. (1982)** — Alcuni aspeti petrologici delle ofioliti delle Albanidi. Ofoliti 2/3.
- Çina A., Tashko A., Tërshana A. (1987)** — The Bulqiza and Gomsiqe Ultrabasic massifs, ophiolites of Albanides: A geochemical comparison. Ofoliti 12 (1).
- Dede S. (1969)** — Mbi ligjësitë e përhapjes së mineralizimeve të shkëmbinjve ultrabazikë. Bul. Usht. ser. shkenc. nat. Nr. 2.
- Gjata K. (1980)** — Petrologjia dhe perspektiva e nikelit sulfur dhe e sulfureve të tjerë të kompleksit gabro-peridotit të Mirditës Perëndimore. Disertacion.
- I.S.P.GJ., I.G.J.N. (1982)** — Gjeologjia e Shqipërisë Tiranë.
- I.S.P.GJ., I.G.J.N. — (1983)** — Harta gjeologjike R.P.S.S.H. në shkallë 1:200 000. Tiranë.
- I.S.P.GJ., F.G.J.M., I.G.J.N. (1985)** — Tektonika e Albanideve. Tiranë.
- Kodra A., Gjata K. (1983)** — Ofolitet në kuadrin e zhvillimit gjeotektonik të Albanideve të brendshme. Përmbyt. Stud. Nr. 2.
- Ndojaj I. (1977)** — Petrokimia e vullkaniteve të bashkësisë ofiolitike të Mirditës Qendrore. Përmbyt. Stud. Nr. 2.
- Premti I. (1984)** — Petrologjia e shkëmbinjve ultrabazikë të rajonit të vendburiut të Bulqizës. Disertacion.
- Shallo M. (1967)** — Vështrim i shkurtër mbi magmatizmin e mineralizimin sulfur të pjesës veriore të zonës së Mirditës. Përmbyt. Stud. Nr. 5.
- Shallo M. (1972)** — Magnatizmi i zonave eugjeosinklinale të Shqipërisë. Përmbyt. Stud. Nr. 1.
- Shallo M., Gjata Th., Vranaj A. (1980)** — Përfytyrime të reja mbi gjeologjinë e Albanideve lindore. Përmbyt. Stud. Nr. 2.
- Shallo M. (1980)** — Petrologjia e shkëmbinjve magmatikë të Mirditës Qendrore dhe mineralizimet sulfure lidhur me ta. Disertacion.
- Shallo M., Kote Dh., Vranaj A., Premti I. (1985)** — Magmatizmi ofiolistik i R.P.S. të Shqipërisë.
- Shallo M., Kote Dh., Vranaj A. (1987)** — Geochemistry of the volcanics from ophiolitic belts of Albanides. Ofoliti 12 (1).
- Shallo M., Kote Dh., Vranaj A., Premti I. (1986)** — A view on ophiolites of Albanides and their metallogeny. Int. geological collaboration for the metallogeny of ophiolites (IGCP 197). Athens 1986.
- Tashko A. (1976)** — Disa dallime gjeokimike që vërehen brenda shkëmbinjve ultrabazikë. Përmbyt. Stud. Nr. 4.
- Tërthana A. (1982)** — Petrologjia dhe metalogjenia e kompleksit gabroperidotit të rajonit Kashnjet-Qelzë. Disertacion.
- Turku I. (1981)** — Petrologjia e vullkaniteve mesozoike të zonave Krastë-Cukali dhe Mirdita dhe mineralmbajtja e tyre. — Disertacion.
- Vranaj A. (1983)** — Petrologjia e shkëmbinjve magmatikë të rajonit të Tropojës. Disertacion.

- Beccaluva L., Piccardo G., Serri G.** (197) — Petrology of Northern Apennine Ophiolites and comparison with other Tethyan Ophiolites. *Ophioliti* 4.
- Coleman R.** (1978) — Ophiolites: Ancient oceanic lithosphere.
- Economou M.** (1983) — Platinum group metals in chromite ores from the Vourinos ophiolite complex. Greece; *Ophioliti* 8 (3).
- Irvine T.N., Baragar W.R.** (1971) — A guide to the chemical classification of the common volcanic rocks. (*Canad. Journ. Earth scienc.*)
- Marçell M., Ohnenshtetter D.** (1983) — The ophra data bank. *Ophiolites: Oceanic tectonics and metamorphism*. *Ophioliti* suppl. et. vol. 8.
- Miyashiro A.** (1975) — Classification, characteristic, and origin of ophiolites.
- Nicolas A., Jackson E.D.** (1972) — Repartition en deux provinces des peridotites des chaines alpines longuement la Méditerranée, implication géotectoniques. *Bull. suis. Min. Petr.* 52.
- Nicolas A.** (1984) — Lhercolites of the western Alps, a structural review. In *Kimberlites II. The mantle and Crust-Mantle relationships*.
- Ohnenshtetter M.** (1987) — The origin of chromite deposits inferred from the petrologie and structural diversity of ophiolites. *Ophioliti* 12 (I).
- Pantazis Th.** (1980) — Ophilites of Cyprus. *Ophioliti* 2.
- Roecci G., Ohnenshtetter D., Ohnenshtetter M.** (1975) — La dualité des ophiolites tetysince. *Petrologie* vol. I.
- They. P.** (1983) — The nature of the Troodos boninites. A comparision with Marian, Papua and Bonin High magnesian andestites. *Ophiolites* vol. 8.

*Dorëzuar në redaksi në dhjetor 1988.*

#### *S u m m a r y*

#### **Some petrological features of the ophiolite of Albanides**

The Ophiolite of Albanides are a component part of the alpine mediterranean ophiolite belt localized at the sector between «western» and «eastern» ophiolites; they occupy an area of about 4300 km<sup>2</sup>. At the northern margin, through Shkodër-Pejë transversal, they confront with the Cukali and Valbona subzones, following in the south with the ophiolites of Pindos-Vourinos. Their age dates to the Middle-Upper Jurassic.

Based on the petrographical, petrochemical and metallogenetic features, among the ophiolite of Albanides are distinguished the «western» ophiolites, belonging to the first «lherzolitic» type or to A suite of the second type of the mediterranean alpine ophiolites (in early cumulates rich in plagioclase associated with TiO<sub>2</sub>- rich melting) and, the «eastern» ones, most similar to the second «harzburgite» type or to B and C suites of the second ophiolite type (with cumulates rich in pyroxene, associated with melting impoverished in TiO<sub>2</sub>). These characteristics are clearly shown at the northern ophiolitic sector with the intensive

development of ophiolitic magmatism.

The «eastern» ophiolites consist mainly of harzburgite tectonites and rarely of dunite ones, followed upwards by the dunite cumulate and rarely wehrlite-herzolite and pyroxenite ones. More above continue gabbroic cumulates, isotropic gabbros, quartz diorites-plagiogranites, followed upwards by the sheeted dyke complex and volcanics of the basalt-dacitic serie, which are covered by radiolaritic cherts ( $J_3^{Kt}$ ) and flyschoidal sediments ( $J_3^L$ - $Cr_1$ ). They are characterized by the cumulate sequence of «gabbro norite» type with well expressed differentiation trend up to intermediate acid-acid sorts of the magmatic constituents, where the saturation in  $SiO_2$  and impoverishment in  $TiO_2$  of the petrochemical types similar to the ensimatic island arc ones are evident.

The «western» ophiolites consist of the ultrabasic tectonites (harzburgite-herzolite) which are overlain by the plagioclase lherzolites, dunites and plagioclastic dunites, ending with the levels of troctolites or olivinic hornblendites and more seldom gabbro cumulates and trondhjemites; the section closes with the basic volcanics (unsaturated tholeiites rich in  $TiO_2$ ) similar to the basalts of mid-oceanic ridges. They are characterized by the cumulate sequences of the «troctolite» type.

The belonging of «western» ophiolites to the first type («lherzolitic») suggests the interpretation of their formation as due to the oceanic spreading of a narrow oceanic basin and a relatively restricted partial melting (lherzolitic-peridotitic), whereas the «eastern» («harzburgitic») ophiolites are interpreted as formed in the ensimatic island arc environment or marginal sea and are characterized by high grade of the melting of mantle.

These characteristics condition the differences in the metallogenetic features, clearly expressed in their plutonic sequence.

The close spatial relation of the «western» and «eastern» ophiolites, the presence of their earlier sedimentary cover of the same stratigraphic level and the history of geotectonic development is in conformity to the petrological differentiations of these two ophiolitic belts.

## NDËRTIMI GJEOLOGJIK DHE VEÇORITË PETROLOGJIKE TË MASIVIT ULTRABAZIK TË VALLAMARËS

K. Onuzi\*, B. Pojani\*\*

Përshkruhet vendosja gjeologjike e masivit ultrabazik të Vallamarës dhe marrëdhëniet e tij me shkëmbinjtë rrethues. Njëkohësisht jepet prerja e hollësishme magmatike, duke dalluar formacionet tektonite e kumulate, veçoritë e tyre petrografike, petrologjike e petrokimiike të masivit.

Artikulli është rezultat i një pune dy vjeçare kërkim-rilievimi gjeologjik kompleks në shkallë 1:25000.

### H Y R J E

Në kuadrin e kërkim-rilievimit kompleks në shkallë 1:25000 të kryer nga autorët gjatë viteve 1985-1987 në masivin ultrabazik të Vallamarës, u arriten një sërë rezultatesh në njohjen e ndërtimit gjeologjik e të petrologjisë së këtij masivi (7). Në këtë artikull jepen disa nga këto arritje. Masivi i Vallamarës ndodhet në pjesën juglindore të Shqipërisë dhe shtrihet në rrëthet Korçë-Pogradec-Gramsh; zë një sipërfaqe prej rrëth 74 km<sup>2</sup>. Ai përfaqëson një krahinë malore, me riliev të thyer. Në qëndër të tij ngrihet mali i Vallamarës (2373 m). Në këtë masiv gjenden cirqe komplekse dhe komplekse cirqesh, lugjet dhe shpatulloret akullnajore (9). Në to përmendim cirkun kompleks të Ligenit të Zi, të Moçalit të Ariut, Fushës së Vallamarës ku ndodhen liqenet akullnajore, lugu akullnajor i Grykës së Bojës etj.

### NDËRTIMI GJEOLOGJIK I MASIVIT TË VALLAMARËS

Në ndërtimin gjeologjik të masivit ultrabazik të Vallamarës marrin pjesë kryesishët shkëmbinjtë ultrabazikë dhe më pak ata bazikë. Ky masiv është pjesë përbërëse e brezit perëndimor të sektorit jugor të zonës Mirdita.

Në veriperëndim, masivi kontakton me depozitimet flishoidale të kufirit jurasiko-kreatak të Gurit të Topit; në perëndim mbihipën mbi depozitimet flishore të nënzonës së Krastës dhe pjesërisht mbi për-

\*) Institut i Stud. dhe Projek. të Gjeologjisë në Tiranë.

\*\*) Ndërmarrja Gjeologjike në Korçë.

Problemet e karakterit petrologjik duhet të thellohen akoma më shumë në të ardhmen.

## P È R F U N D I M E

1. Masivi ultrabajzik i Vallamarës ka marrëdhëniet tektonike me gëlqerorët triasiko-jurasike, depozitimet e kufirit jurasiko-kretak dhe fli-shin e mastriktian-paleogenit mbi të cilët është mbihipur dhe mbulohet transgresivisht nga depozitime të kufirit jurasiko-kretak e molasa oligocenike.

2. Masivi ka ndërtim të rrudhosur, evidentohet një sinklinal i madh në skajin perëndimor dhe disa rrudha të rendeve të ulta në skajin lindor.

3. Prerja e masivit të Vallamarës ndërtohet kryesisht nga tektonite ultrabajzike ku mbizotërojnë harzburgitet me pak piroksen monoklin dhe rrallë dunitet; përhapje më të kufizuar kanë kumulatet ultrabajzike. Tektonitet ultrabajzike përfaqësojnë mbetje të mantelit të varfëruara, ndërsa kumulatet ultrabajzike, përfaqësojnë diferenciatet më të hershëm të shkrirjes bazaltike.

4. Qenia e ndërthurjeve harzburgit-dunit në analogji me brezin lindor përbën një premisë të favorshme për kromite.

## L I T E R A T U R A

1. Çina A. 1967 Mineralogjia e kromiteve të masivit ultrabajzik të Bulqizës. Bul. Shk. Gjeol. nr. 3.
2. Çili P. 1960 Ultrabajzikët e Shqipërisë juglindore. Tiranë.
3. Godroli M. etj. 1987 Karakteristikat petrografike e petrokimike të prerjes magmatike të masivit ultrabajzik të Shpatit Bul. Shk. Gjeol. nr. 2.
4. Gjata K., Kodra A., Mustafa F., Zhukri E. 1985 Marrëdhëniet intruzive të shkëmbinjve ultrabajzikë me shkëmbinjtë karbonatike Triasiko-Liasike në pjesët anësore të zonës Mirdita dhe në zonën e Korabit. Bul. Shk. Gjeol. nr. 4.
5. Kodra A. Gjata K. 1982. Ofiolitet në kuadrin e zhvillimit gjeotektonik të Albanideve Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2.
6. Marishta S. 1982 — Raport mbi kërkim-rilevimin e rajonit Guri i Topit-Kukur-Lenie dhe të masivit ultrabajzik të Gramshit në shkallë 1:25 000. Tiranë.
7. Onuzi K., Pojani B. 1987 Raport mbi kërkim-tilevimin e rajonit Ujëbardhë-Voskopojë-Vallamarë. Tiranë.
8. Pulaj H., Godroli M. — 1985 Ndërtimi gjeologjik dhe mineralet e dobishme të rajonit Guri i Topit-Polis — Guri i Muzhaqt. Tiranë.
9. Qiriazi P. 1985 Gjeografja fizike e Shqipërisë. Tiranë.
10. Shallo M. etj. 1980 Përfytyrime të reja mbi gjeologjinë e Albanideve Lindore. Përmbledhje Studimesh Nr. 2.
11. Shallo M. etj. 1981 Vendosja hapsinore e shkëmbinjve ultrabajzikë të vendit tonë. Tiranë.
12. Shallo M., Kote Dh., Vranai A., Premti I. 1985 Magmatizmi ofiolitik i R.P.S. SH. Tiranë.

13. Coleman R.G. 1977 «Ophiolites» New York, 1977.

Dorëzuar në redaksi në dhjetor 1988.

### *S u m m a r y*

#### **Some features of the geological construction and petrology of the Vallamara ultrabasic massif**

This article gives the results of investigations of two years carried out in the Vallamara massif (7), treating the problems of geological construction, petrology and its mineral-bearing.

Based on the detailed geological-petrographical and petrochemical investigation, is given the complete magmatic section of this massif, distinguishing tectonite and cumulate ultrabasic sorts, as well as the rest of the volcanic basaltic serie.

Fig. 1. Geological map of the Vallamara massif scale 1:100.000 in conformity to the map scale 1:25.000 and the respective sections.

Fig. 2. Generalized section of the massif.

Fig. 3. Magmatic section of the Vallamara ultrabasic massif scale 1:25.000.

Fig. 4. The division of the ultrabasic rocks into tectonites and cumulates, based on the graphic presentation, chemical analysis in chemidiagrammes AFM and CaO-Al<sub>2</sub>O<sub>3</sub>-MgO (according to Coleman, 1977).

Fig. 5. SiO<sub>2</sub>-FeO /MgO graph of the ultrabasic rocks of the Vallamara massif (the-division fields according to Miyashiro, 1975).

## MBI MOSHËN JURASIKE TË SIPËRME TË PAKOS «ARGJILITE COPËZORE» NË MIRDITËN QËNDRORE

**Kadri Gjata\*, Faruk Mustafa\*\*, Agim Pirdeni\***

Argumentohet biostratigrafikisht si e Jurasikut të Sipërm mosha e pakos argjilite copëzore. Kjo pako diferencohet qartë nga vendi gjeologjik, si dhe nga litologja, prej depozitimeve transgresive të titonian-berriasianit, që shënojnë fazën orogjene jurasiko-kretake.

### H Y R J E

Problematika gjeologjike e pakos argjilite copëzore është një nga çështjet që ka ngjallur diskutime të shumta midis gjeologëve, që kanë studjuar zonën e Mirditës. Ndër të tjera, aspekti moshor i saj ka qenë dhe mbetet objekt diskutimesh. Vite më parë shumica e autorëve e kanë pranuar atë si të triasikut të poshtëm-të mesëm. Më vonë, në vitin 1966, në bazë të gjetjes së bloqeve të gëlqerorëve biomikritikë me kalzionelidë në Qafën e Lisit (Mirdita Qëndrore) ajo u përcaktua si e titonian-valanzhinianit (16,17). Studjues të tjerë, formimet argjilite copëzore, që takohen në Mirditën Jugore, të shoqëruara me vullkanogjenet, i pranojnë si të jurasikut të poshtëm-të mesëm (9) ose i kanë trajtuar ato si «përzierje» tipike dhe jo formim sedimentar normal, që i përket jurasikut të mesëm (10). Ndërkaq, në shëmbullin e rajonit të Poravit, ku gjen përhapje seria vullkanogjene-sedimentare, u argumentua vendosja e pakos rreshpore me copa (një variant facial i formimeve argjilite copëzore) mbi gëlqerorët triasiko-jurasikë, duke i atribuar asaj moshën e jurasikut të mesëm deri të sipërm (6).

Gjatë punimeve të rilevimit 1:25 000, në vitet 1976-1978 në rajonin e Rrëshen-Dervenit, u gjetën argumente biostratigrafikë për moshën e jurasikut të sipërm të pakos argjilite copëzore (1). Punimet e rilevimit në shkallë 1:10 000, të kryera në vitet 1980-1982, gjithashtu përcaktuan moshën e jurasikut të sipërm për këto formime (5).

\* Institut i S.P. të Gjeologjisë në Tiranë.

\*\*) N. Gjeofizike në Tiranë.

apo jo, uniteti i saj me serine vullkanogjeno-sedimentare etj., janë çështje që natyrisht kërkojnë studime të mëtejshme në të ardhmen.

## PËRFUNDIMI

1. Mosha e pakos argjilite copëzore e zonës Mirdita kufizohet në jurasikun e sipërm (pjesa e poshtme-e mesme e titonianit) sepse niveli më i poshtëm i depozitimeve jurasiko-kretake, që vendosen transgresivisht mbi të, karakterizohet nga zhvillimi i biozonës *Crassicollaria*, që argumenton pjesën e poshtme-të mesme të titonianit të sipërm.

2. Ekziston një ndryshim i qartë litologo-facial midis pakos argjilite copëzore dhe depozitimeve konglobrekçiore të titonian-berriasanit, që shprehet kryesisht me praninë në to të ofiolitoklasteve.

3. Faza orogjene e jurasiko-kretakut në Albanide shprehet me depozitimet konglobrekçiore të titonian-berriasanit dhe jo me formimet argjilite copëzore, që përfundojnë krijimin e tyre të njëhershëm apo të përsëritur deri në jurasikun e sipërm.

## LITERATURA

1. Gjata K., Shtjefanaku D. etj. (1978) Ndërtimi gjeologjik dhe mineralet e do-bishme të rajonit L. Sh. Tiranë.
2. Gjata K., Kodra A., Pirdeni A. (1980) Gjeologjia e disa pjesëve periferike të zonës Mirdita. Përmbl. Stud. nr. 3 Tiranë.
3. Gjata Th., Theodhori P., Kici V., Marku D., Pirdeni A. (1987) — Stratigrafia dhe kushtet e formimit të depozitimeve jurasike në pjesët periferike të zonës Mirdita (Albanidet Lindore) Bul. shk. gjeol. nr. 4 Tiranë.
4. Kanani J., Grazhdani A. (1977) Përhapja e coprave të rodokrozitit në suitën «Argjilite copëzore» të Mirditës (përreth Rrëshenit) dhe perspektiva e kërkimit të mëtejshëm. Përmbl. Stud. Nr. 4 Tiranë.
5. Koço N., Mustafa F., Shtjefanaku D. etj. (1986) Raport i punimeve komplekse për vitet 1980-1982 në rajonin G. Tiranë.
6. Kodra A. (1976). Mbi moshën jurasike të formacionit vullkanogjeno-sedimentar. Përmbl. Stud. nr. 1 Tiranë.
7. Kodra A. (1981) Shkëmbinjtë jurasikë dhe jurasiko kretakë në rajonet verilindore të Albanideve. Përmbl. Stud. Nr. 3 Tiranë.
8. Kodra A., Gjata K. (1982) Ofiolitet në kuadrin e zhvillimit gjeotektonik të Albanideve të brëndëshme. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2 Tiranë.
9. Melo V., Turku I., Kote Dh., Zeqja K., Dodoma E. (1971) — Mbi moshën jurasike të poshtme e të mesme të seriёs vullkanogjeno-sedimentare në rajonin Vithkuq Rehovë Selenicë e Pishës. Bul. USHT ser. shk. nat. nr. 3 Tiranë.
10. Mustafa F. (1974) — Mbi të ashtuquajturën pako «argjilite copëzore» dhe disa rrjedhime që dalin prej saj. Përmbl. Stud. nr. 2 Tiranë.
11. Pirdeni A. (1981) *Calpionellidae* të titonianit të sipërm-valanžhinianit të disa rajoneve të vendit tonë. Tiranë.
12. Pirdeni A. (1982) Biostratigrafia dhe mikrofauna e depozitimeve mesozoike të rajonit të Cukalit. Disertacion. Tiranë.

13. Petro Th. (1980) Fakte dhe interpretime të reja për gjeologjinë e rajonit të Korçës. Përmbl. Stud. nr. 2 Tiranë.
14. Pulaj H., Godroli M. etj. (1982) Raport mbi ndërtimin gjeologjik dhe mineralet e dobishme të rajonit Leskovik-Ersekë. Fondi ISPGJ.
15. Qirinxhi (Spiro) A. (1969) Gjetja e gëlqerorëve liasikë në trajtë fragmentesh tektonikë në rajonin e Rubikut. Përmbl. Stud. nr. 3. Tiranë.
16. Shallo M. (1966) Disa të dhëna të reja mbi magmatizmin efuziv në rajonin e Munellës. Bul. USHT. ser. shk. nat. n. 4 Tiranë.
17. Shallo M. (1975) Mbi suitën «argjilo copëzore» të Mirditës. Përmbl. Stud. nr. 1 Tiranë.
18. Shallo M., Vranaj A., Gjata Th., Gjeçi K. (1983) Rreth gjeologjisë së rajonit të Rubikut. Bul. shk. gjeol. nr. 1 Tiranë.
19. (1982) Teksti shpjegues i Hartës Gjeologjike të RPSSH, shkallë 1:200.000 Tiranë.

Dorëzuar në redaksi në dhjetor 1988.

Fig. 1-3 *Crassicollaria massutiniana* (COLOM).

Fig. 1,3 Shlifi nr. 491, Derven

Fig. 2: Shlifi nr. 490, Derven

Fig. 4 *Crassicollaria intermedia* (DURAND DELGA)  
shlifi nr. 491, Derven

Fig. 5 *Crassicollaria* sp., shlifi nr. 491, Derven.

Fig. 6 *Crassicollaria* cf. *parvula* REMANE  
Shlifi nr. 491, Derven

Fig. 7 *Crassicollaria massutiniana* (COLOM)  
Shlifi Nr. 492, Derven

Fig. 8 *Crassicollaria parvula* REMANE  
Shlifi nr. 491, Derven

Fig. 9. *Crassicollaria* cf. *colomi* DOBEN  
shlifi Nr. 492, Derven

Fig. 10 *Calpionella alpina* LORENZ  
Shlifi Nr. 492, Derven

Shënim: Të gjitha figurat janë zmadhuar 100 x.

*S u m m a r y***On the Upper Jurassic Age of the Argillic-Clastic Pack (Central Mirdita)**

There exist many views on the geological problems of the argillic-clastic pack. Its age aspect has been also widely discussed. Various authors have considered it as dating back to the Lower-Middle Triassic, Lower-Middle Jurassic, Middle Jurassic, Upper Jurassic and of the Jurassic-Cretaceous Age.

This article provides biostratigraphic data on the Upper Jurassic Age. On the argillic-clastic formation transgressively lie Tithonian-Berriasiyan deposits. Their lower most level is characterized by the presence of Crassicollaria biozone speaking for the Lower-Middle part of the Upper Tithonian. This level represents the upper age boundary of the argillic-clastic pack. The level with Crassicollaria is recorded for the first time in the Mirdita zone.

From the lithological-facial aspect, the argillic-clastic formations are essentially distinguished from the Jurassic-Cretaceous deposits. The latter are distinguished by the presence of ophioclasts. On the contrary, no ophiolitic matter has been recorded in the argillic-clastic pack.

The Jurassic-Cretaceous orogeny in Albanides is expressed by the Tithonian-Berriasiyan conglobreccias deposits and not by the argillic-clastic formations, which end their simultaneous or repeated formation to the Upper Jurassic.

# STRUKTURAT E BREZIT ANTIKLINAL TË BERATIT SI PJESË PËRBËRËSE E ZONËS JONIKE NUK NDËRPRITEN POR MBULOHEN NGA EVAPORITET E DUMRESË

**Irakli Premti\*, Isa Bajo\*\*, Luftar Bandilli\*\*\* —**

Mbi bazën e përgjithësimit të të gjithë materialit gjeologjik, sismik e gjeofizik për rajonin e Dumresë dhe të studimeve të arlikujve të bërë kohët e fundit për zonën Jonike e për Albaniat nga autorë të ndryshëm, në këtë artikull jepen mendime mbi ndërtimin gjeologo-strukturor të rajonit të Dumresë dhe marrëdhëniet me zonat kufizuese, mbi mekanizmin e ri të formimit të evaporiteve. Shpjegohet se evaporitet në vendin e daljes së sotme sipërfaqësore kanë karakter mbulesor. Mendimet që paraqiten në këtë artikull janë frut i punës përgjithësuese të bërë nga grup autorësh (11).

## Ndërtimi gjeologjik i zonës së Dumresë

Evaporitet e Dumresë kanë dalje në trajtë ovale dhe arrijnë sipërfaqen gati  $210 \text{ km}^2$ . Shtreni nga Q. Stalin e deri në jug të lumit Shkumbin, dhe nga fshati Kosovë në perëndim e deri në afërsi të Linas-Marakut në lindje. Në vendin e sotëm hapsinor Dumreja gjendet në vazhdimësinë veriore të strukturave të brezit antiklinal të Beratit, që bëjnë pjesë në zonën tektonike Jonike (fig. 1).

Në zonën Jonike përveç evaporiteve të Dumresë gjenden edhe dalje të tjera evaporitesh, që vendosen në trajtë zinxhinore sipas prishjeve regionale gjatësore.

Vendosja e orientuar e daljeve evaporitike sipas linjave tektonike gjatësore të kombinuara me ato tërthore tregon qartë lidhjen e tyre me to, por në të njëjtën kohë tregon dhe influencën e evaporiteve në intensitetin dhe shkallën e zhvillimit të linjave tektonike. Pra tekto-

\* Instituti i Studimeve dhe Projekteve të Gjeologjisë në Tiranë.

\*\* Ndërmarrja Gjeologjike në Gjirokastër.

\*\*\* Instituti Gjeologjik i Naftës dhe Gazit në Fier.

Konfiguracioni i sotëm i depozitimeve mollasike të tortonianit dhe të depozitimeve flishore të krahut jugor, perëndimor e verior tregojnë se forcat e lëvizjes dhe të shtytjes së masës evaporitike kanë qenë më të mëdha në krahun verilindor të tij, dhe se «dyshemeja» e diapirit nuk ka qenë e rrafshëtë por ka patur ngritje e ulje sipas formave strukturore të paleorelievit, për rrjedhojë niveli i prerjes të masave flishore nga evaporitet nuk ka qenë kudo i njëjtë. Impulsi i tretë që përbën revolucionin në aspektin e intensitetit të diapirizmit krijoi kushte përmim e strukturave mbihipëse mbulesore.

Në fund të pliocenit rajoni ju nënshtrua etapës së fundit të tekto-gjenezës plikuatërnare e cila rivuri në veprim shkëputjet e vjetra. Falë forcave tangenciale zbuten dhe më tej vendet e prishjeve duke shkaktuar rritjen e mbihipjeve të karakterit mbulesoro-luspor.

### Përfundime

1 — Evaporitet e Dumresë kanë trajtë diapirike mbulesore dhe jo kupolare siç mendohej më parë, me vend shpërthimi në lindje të rajonit. Evolucioni i diapirit është gjithëkohor e me kërcime sipas fazave të tektogjenezës dhe në unitet me të tri komplekset shkëmbore që e ndërtojnë atë (bazament, kripë, mbulesë).

2 — Trajtat që shikohen sot në strukturat e Dumresë janë rezultat i bashkëveprimit të forcave vertikale e horizontale, i forcave të rëndesës dhe i energjisë së brendshme të evaporiteve, për hirë të pri-shtesë së izostatisë dhe hidratimit të tyre.

3 — Lëvizja e evaporiteve duhet të jetë bërë kryesisht sipas kontaktit flish-gëlqerorë ose brenda flishit oligocenik. Masa evaporitike me mundësi më të mëdha mbulon strukturat flishoro-karbonatike të brezit të Beratit.

4 — Vendi kryesor i shpërthimit të diapirit ka qenë në afërsi të Cërrikut aty ku ndërpritet linja tektonike tërthore e Shkumbinit me gjatësoren **Kullës-Q.Stalin-Marak**.

5 — Si rezultat i veprimit të forcave tektonike e halotektonike brezat dhe linjat strukturore kanë ndërtim luspor, mbihipës me drejtim të zhvendosjes nga lindja drejt perëndimit.

6 — Zona Jonike më në veri të thyerjes tërthore Elbasan-Lushnje duhet të pësojë «ekranizim» apo «ngushtim» në gjerësi e përm rrjedhojë ajo nëpërmjet basenit të Adriatikut do të kontaktojë e mbivendoset mbi zonën platformike të Sazanit.

### LITERATURA

- 1 — **Aliaj Sh., Kondo A. (1971)** — Skicë mbi paleogeografinë e strukturave Jonike. Bul. UT, ser. Shk. Nat., nr. 3.
2. — **Aliaj Sh. (1974)** — Evaporitet e zonës Jonike askund nuk takohen në pozicion normal stratigrafik. Përmb. Stud., nr. 3.
- 3 — **Aliaj A. (1987)** — Disa çështje themelore të evolucionit strukturor të zonave të jashtme të Albanideve. Bul. Shk. Gjeol., nr. 4.

4. — **Bajo I. (1974)** — Problemi i moshës së shkëmbinjve halogenë në zonën Jonike. Përmb. Stud., nr. 2.
- 5 — **Bajo I. (1984)** — Evaporitet e zonës Jonike, dukuritë diapirike të tyre dhe perspektiva e mineraleve të ngurta në strukturat që formojnë ato. Disertacion. Gjirokastër.
- 6 — **Bajo I. (1976)** — Mënyra e diapirizmit të halogjeneve Permo-Triasik dhe skema e zhvillimit paleogeografik e strukturor në zonën Jonike, interpretuar në ndikimin e këtyre dukurive. Bul. Nafta dhe Gazi, nr. 2.
- 7 — **Bakiaj H. (1982)** — Mbi përhapjen e evaporiteve në zonën Jonike. Referat, Fier.
- 8 — **Bakiaj H. etj. (1982)** — Diapirizmi i shkëmbinjve evaporitik në zonën Jonike. Bul. Nafta dhe Gazi, nr. 2, Fier.
- 9 — **Bandilli L. etj. (1974)** — Raport gjeologjik i rilevimit në shkallë 1:50 000 të rajonit të Kurveleshit. Fier.
- 10 — **Bandilli L. etj. (1976)** — Stratigrafia e depozitimeve të neogenit midis brezave antiklinalë të Kurveleshit e të Beratit. Përmb. Stud., nr. 1.
- 11 — **Bandilli L., Velaj T., Premti I., Bajo I. etj. (1988)** — Përgjithësimi gjeologo-gjeofizik i rajonit të Dumresë. Fier.
- 12 — **Dalipi H. (1974)** — Stratigrafia dhe paleogeografia e depozitimeve të ultë-sirës pranadriatike. Fier.
- 13 — **Grazhdani A. (1987)** — Metalogjenia e thyerjeve tërthore të Albanideve. Bul. Shkenc. Gjeol. nr. 4.
- 14 — **Gjata Th., Skela V.** — Përfytyrim strukturor zonave Krastë Cukalit, Krujës, Jonike dhe Sazanit.
- 15 — Harta gjeologjike e RPSSH dhe teksti svarues i saj. Tiranë, 1984.
- 16 — Harta tektonike e RPSSH dhe teksti svarues i saj. Tiranë, 1985.
- 17 — **Kondo A. (1970)** — Mbi qënien e strukturave Jonike qysh në jurasikun e ëndësies dhe zhvillimin e tyre nënujor. Bul. UT, ser. Shk. Nat., nr. 3.
- 18 — **Sulstarova E., Koçaj S., Allaj Sh. (1980)** — Rajonizimi sismik i RPSSH. Akademia e Shkencave të RPSSH. Tiranë.
- 19 — **Sulstarova E. (1986)** — Mekanizmi i vatrave të tërmetave në Shqipëri dhe fusha e sforsimeve tektonike të sotme. Bul. Shkenc. Gjeologjike, Tiranë.
- 20 — **Velaj T. (1974)** — Raport gjeologjik i rilevimit në shkallë 1:50 000 të rajonit Delvinë-Fushë Bardhë. Fier.
- 21 — **Velaj T. (1974)** — Diapirizmi evaporitik në kupolën e Dumresë dhe rëndësia e tij në kërkimin e naftës dhe të gazit. Disertacion.
- 22 — **Velaj T. (1985)** — Roli i tektonikës evaporitike në përcaktimin e fizionomisë të zonës Jonike. Bul. Nafta dhe Gazi, nr. 1.
- 23 — **Desio A. (1985)** — L'origine e l'evoluzione del bacino Mediteran, Milano.
- 24 — **Kitik V.J. (1963)** — Reslovija obrosovaniye soljanih struktur I.Z.D.A.K. NC, ak. SSR, Kiev.

*Summary*

(The structures of the Berati anticline belt, the component parts of the Ionian zone, do not be intersected, but are covered by the evaporites of Dumre)

This article gives data on the geological-tectonic and structural construction of the region of Dumre and of the eastern and western surrounding ones.

A new concept on the form of the evaporite and its mechanism of formation is formed thanks to the spatial setting, relation with the lateral deposits, the form and the nature of the contact between the evaporite and lateral deposits, seismic and geophysical data.

The evaporite has a nappe view and not cupola view. The cupola form of the subvertical uplift has occurred in north-east, far from the place where it is now exposed. By a vertical uplift in time and space it gradually assumes a nappe character, towards west, moving and carrying along mainly flyschoidal and partly carbonate masses. Thus, the evaporites at their outcrops do not interrupt the structures of the Berati anticline belt, as previously mentioned, but they cover them. There exists a continuity of southern structures of the Ionian zone under the evaporite of Dumre and north of it. The eruption and the intrusion of the Dumre diapir occurred gradually and not in continuity in time and space, starting from the Triassic-Jurassic up to Pliocene-Quaternary. But, its maximal eruption occurred mainly during and after Tortonian. As places of eruption have served the faults and mostly the places of the intersection between the Elbasan-Lushnje transversal with the Devoll longitudinal one.

As a result of the motion of Inner Albanides from east towards west, an active role has also been played the halotectonics of the evaporitic diapirism, giving a nappe character to the tectonic zones of Albanides.

The Elbasan-Lushnje transversal which is intersected by the Divjakë-Ardenicë-Vlorë longitudinal one has played an important role in the paleogeography of the Ionian zone and its relations with the surrounding platformic zones of Kruja east and the Sazani west, where the Kruja zone is situated with subduction on the Ionian zone and the latter on the Sazani one. The seismic data, the presence of the negative gravimetric anomaly of the Lazri coast-Dumre-Vlorë and the presence of a very thick deposit of Miocene-Pliocene west and north of the Elbasan-Lushnje transversal speak also in favour of a nappe character of the outer zones of Albanides.

Fig. 1. The scheme of the tectonic regionization of Outer Albanides (according to I. Premti, I. Bajo, L. Bandilli, 1988).

1. Korabi zone; 2. Mirdita zone; 3. Krasta-Cukali zone; 4. Kruja zone;
5. Sazani zone; 6. Ionian zone; 7. Miocene evaporitic formation; 8. P-T<sub>1</sub> evaporitic formation; 9. The possible continuation of the structural belts;
10. Supposed tectonics; 11. Verified tectonics; 12. Verified overthrust; 13. Supposed overthrust.

Fig. 2. Geological-structural scheme of the Dumre region (according to the Geological Map of PSR of Albania elaborated by I. Premti, I. Bajo, L. Bandilli)

1. Mixed deposits; 2. Pliocene: conglomeratic-sandstone; 3. Pliocene: aleuro-

lites; 4. Clayes, sands, 5. Mesinian: sandstone, gypsum, argillas; 6. Tortonian: conglomerate argillas, 7. Helvetian: argillas, lithotamnic limestones, sandstones; 8. Burdigalian: marls, aleurolites, lithotamnic limestones; 9. Aquitanian: conglomerates, argillas, sandstones; 10. Upper Oligocene: argillic-sandstone flysch, limestones, coals; 11. Middle Oligocene: argillic-aleurolitic flysch; 12. Lower Oligocene: aleurito-argillic flysch, 13. Undivided Eocene: limestones; 14. Maestrichtian: argillic-sandstone flysch, limestones; 15. Upper Cretaceous: limestones; 16. Permo-Triassic: evaporites; 17. Limestones with megalodonts; 18. Verified tectonic line; 19. Supposed tectonic line; 20. Verified overthrust; 21. Supposed overthrust, 22. Direction, geological section.

Fig. 3. 3a- latitudinal section 3-3; 3b- Longitudinal section 4-4.

Fig. 4. Scheme of the paleotectonic and paleogeographic of the Dumre region (according to I. Premti, I. Bajo, L. Bandilli, 1988).

1. Terrigenous deposits of  $N_1^3-N_2$ ; 2. Terrigenous deposits of  $N_2^4$ ; 3. Marly deposits of  $N_w^b$ ; 4. Flyschoidal deposits of N; 5. Oligocene flyschoidal deposits Pg $_1^3$  (cipro); 6. Oligocene flyschoidal deposits Pg $^{12}$  (opima opima); 7. Oligocene flyschoidal deposits Pg (ampliapertura); 8. Paleogene-Eocene limestones (Pg $_{1-2}$ ); 9. T $_{2-3}$ , J $_{1-3}$ , Cr $_{1-2}$  carbonate formation (limestones, dolomites); 10. P-T evaporites; 11. Transgressive boundary; 12. Supposed tectonic line; 13. Verified tectonic line; 14. Verified overthrust; 14. Supposed overthrust; 16. Normal geological boundary.

Fig. 5. Scheme of the influence of the evaporite to the style of the paleotectonic development of the structures of the Ionian zone.

Fig. 6. Spatial view of the evaporite of Dumre (according to I. Premti, I. Bajo, L. Bandilli, 1988).

## MINERALET E DOBISHME

# KARAKTERISTIKAT GJEOLOGO-STRUKTURORE TË ZONËS BULQIZË-BATËR-THEKËNTË MASIVIT ULTRABAZIK TË BULQIZËS DHE PERSPEKTIVA KROMBAJTËSE

Sefedin Qorlaze\* Shadan Stërmasi\*

Paraqiten të dhëna mbi ndërtimin gjeologjik, karakteristikat morfologo-strukturore, ligjësitë e përhapjes të mineralizimit dhe mendime për perspektivën krombajtëse të zonës Bulqizë-Batër-Thekën.

### H Y R J E

Zona Bulqizë-Batër-Thekën përbën atë pjesë të masivit ultrabazik të Bulqizës ku janë zbuluar dhe vënë në shfrytëzim vendburimet më të mëdha dhe më të rëndësishme të vendit tonë si: Bulqiza, Batra, Thekna etj. Në këtë pjesë të masivit janë kryer mjaft punime e studime gjeologjike. Ato kanë bërë të mundur rritjen e shkallës së njohjes, të përfytyrimit mbi ndërtimin gjeologjik dhe të perspektivës krombajtëse.

Bazuar në të dhënat gjeologjike të punimeve të kryera nga gjeologja dhe minierat, dhe në arritjet e temave studimore veçanërisht të viteve të fundit, në këtë shkrim jemi përpjekur të përgjithësojmë të dhënat e fituara dhe të japim mendime në veçanti mbi drejtimet e punimeve dhe perspektivën e mëtejshme në këtë pjesë të masivit të Bulqizës.

### Mbi ndërtimin gjeologjik të zonës Bulqizë-Batër-Thekën

Zona Bulqizë-Batër-Thekën përfaqëson sektorin boshtor (3,5,7,8) të gjysmës jugore të masivit ultrabazik të Bulqizës (fig. 1). Këtu përfshihen disa vendburime si Bulqizë-Batër, «16 Tetori» etj. dhe një numur objekteve të veçanta kromi e shfaqesh të tjera të mineralizuara.

Në ndërtimin gjeologjik të kësaj zone marin pjesë kryesisht llojet harzburgitike dhe dunitike të shkëmbinjve ultrabazikë. Harzburgitet ka-

\* Instituti i Studimeve dhe Projekteve të Gjeologjisë në Tiranë.

6. Intensitet më të madh paraqet zhvillimi i tektonikës zhvendosëse tërthore e tipit falje dhe kundërfalje. Zhvendosja e bloqeve në planin gjërësor është me ngritje nga jugperëndimi në verilindje. Ndikimi i tektonikës shkëputëse është më i pranishëm dora dorës nga veriperëndimi në juglindje. pra nga Bulqiza në Batër e më tej në Thekën.

## LITERATURA

1. Caslli H., Çina A., Gjata K., Kodra, A., Lleshi, B., Shallo M., Vranai A., Zaçë M., 1982. — Alcuni aspetti petrologici della ophioliti dell'Albanidi, Ophioliti vol. 7 2/3.
2. Çina A., Caslli H., Goci L. 1986 — Kromitet në ophiolitet e albanideve. Bul. Shk. Gjeol. nr. 4.
3. Çina A. 1987 Mineralogjia e kromiteve të masivit ultrabazik të Bulqizës. Bul. Shk. Gjeol. nr. 3.
4. Çollaku F., 1987 Raport gjeologjik me llogaritjen e rezervave të v. burimit Batër.
5. Dobi A. 1980 Raport mbi studimin tematiko përgjithësues e kërkues të punimeve komplekse gjeologo-gjeofizike për prognozën e krombajtjes të masivit ultrabazik të Bulqizës.
6. Jahja B. etj. 1985 — Projekti i punimeve të kërkim-zbulimit të vendburimit Bulqizë.
7. Premti I., Stërmasi Sh., etj. 1986 Studim mbi hapjen dhe konkretizimin e përspektivës të mineralizimit të kromit të pasur në zonën perëndimore të vendburimit Batër.
8. Qorlaze S., etj. Studim përgjithësues për vlerësimin e përspektivës krombajtëse për rrëth vendburimit Bulqizë.
9. Qorlaze S. etj. 1986 Studim mbi çeljen e përspektivës dhe konkretizimin e vazhdimesisë së mineralit të pasur në krahun lindor të vendburimit Bulqizë dhe në zonën ndërmjet Bulqizë-Almarinë — Afér Liqej.
10. Stërmasi Sh., Duni S., Bello S. 1981. Projekt mbi studimin e intensifikimit të punimeve të mineralit të kromit në masivin ultrabazik të Bulqizës në rrëthin e Matit.
11. Shabani S. etj. 1986. Raport gjeologjik me llogaritjen e rezervave të vendburimit Bulqizë.
12. Shallo M. etj. 1981 Vendosja hapsinore e shkëmbinjve ultrabazikë të vendit tonë. Përbledhje Studimesh Nr. 2.

Dorëzuar në redaksi në janar 1988

## S ummary

The geological-structural features of the Bulqiza-Batër-Thekën zone (Bulqiza ultrabasic massif) and its chrome-bearing perspective.

This region lies at the southern part of the Bulqiza ultrabasic massif. The magmatic sequence, from bottom to top, consists of the following facies:

1. Mainly fresh harzburgites with rare dunite lenses.

2. Harzburgite dunite, with which the main mineralization level is linked.
3. Dunite harzburgite, with which the more limited mineralization level is linked.
4. Dunites of the limited extent. They are transitory between tectonites and cumulates with mineralization consisting of small banded and lensy chromitic bodies.

The transition from one facies to another is gradual. The main chromitic mineralization level linked with the harzburgit-dunite facies is characterized by the platy morphology, folded both, in extention and width, forming thus the folds of high ranks (Bulqiza-Batër anticline etc.) up to the low bendings of small dimensions.

Fig. 1. Scheme of the setting of Bulqizë-Batër-deposits at southern part of the Bulqiza massif.

Fig. 2. Longitudinal schematic section of the Bulqiza region.

Fig. 3. Longitudinal schematic section of the ~~Bulqiza~~-Batër-Thekën.

Fig. 4. Schematic vertical projection of Bulqiza-Batër deposit.

Fig. 5. Bulqiza-Batër anticline (generalized section).

Fig. 6. Schematic section of the Batër deposit (central zone).

Fig. 7. Schematic section of the Thekën deposit.

## MINERALOGJI-GJEOKIMI-PETROGRAFI

# SHPËRNDARJA E Ca, Al, Ni, Cr DHE Na NË SHKËMBINJTË RRETHUES TË MINERALIZIMIT TË KROMIT

Ilir Alliu\*

Në artikull trajtohen modelet e shpërndarjes së elementeve  $\text{CaO}$ ,  $\text{Al}_2\text{O}_3$ ,  $\text{NiO}$ ,  $\text{Cr}_2\text{O}_3$  dhe  $\text{Na}_2\text{O}$  në shkëmbinjtë rrethues të mineralizimit të kromit dhe nxirren disa përfundime praktike.

### H Y R . J E

Vitet e fundit, në kuadrin e kryerjes së studimeve komplekse gjeologo-gjeofizike për vlerësimin e perspektivës krombajtëse të disa masivëve ultrabajzike të Albanideve, janë përdorur edhe studimet gjeokimike. Rezultatet e përfshira kanë dhënë ndihmesë në thellimin e njohjes së aftësisë krombajtëse të tyre dhe në prognozimin e sektorëve prespektivë për mineralizimin e kromit.

Aspekti regional i prognozimit gjeokimik të masivëve ultrabajzike është trajtuar në disa punime (Çili P. 1985; Tashko A. 1983; Tashko A. 1987), ndërsa aspekti i mundësisë së përdorimit të modeleve të shpërndarjes së elementeve në shkëmbinjtë rrethues të mineralizimit të kromit në ndihmë të kërkimit mbetet akoma pak i prekur. Në lidhje me këtë problem edhe në literaturën e huaj shëmbujt mungojnë.

Në këtë artikull pasqyrohet një përpjekje e bërë në këtë drejtim, bazuar në rezultatet e studimit të modeleve të shpërndarjes së elementeve  $\text{CaO}$ ,  $\text{Al}_2\text{O}_3$ ,  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ,  $\text{NiO}$  dhe  $\text{Na}_2\text{O}$  në shkëmbinjtë rrethues të mineralizimit të kromit në dy vendburime kromifere të vendit tonë.

### Metoda e kryerjes së studimit

Studimi është realizuar nëpërmjet interpretimit të dhënave analitike për elementet Ca, Al, Cr, Ni, Na, të provave shkëmbore të marrë, në kollonat e 13 shpimeve të v.b. Bulqizë dhe të 14 shpimeve të vendburimit Batër (Stërmasi Sh., etj. 1988; Qorlaze S., etj. 1986; Premti I. etj. 1987).

Shtratimi ultrabajzik i studiuar që përmban mineralizimin kromifer, ka trashësi 350 m deri 400 m. Ai përbëhet nga një mjedis gjeologjik

\* Instituti i Studimeve dhe Projekteve të Gjeologjisë në Tiranë.

